



SHALLI "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
SHLUJ Universiteti "Marin Barleti", Tiranë
Dhe
Qendrës "Jonathan"**

Universiteti "Marin Barleti" (UMB) , me adresë Rruga "Sami Frashëri" Nr. 41 në Tiranë dhe Qendra "Jonathan" me adresë Rruga "Mihal Duri", në Tiranë, nisur nga vullneti për të kontribuar në zhvillimin e arsimit në vendin tonë dhe rritjen cilësore të formimit të studentëve të fushës së psikologjisë dhe punës sociale, si në programe Bachelor dhe Master, bien dakord të bashkëpunojnë në aspektet si më poshtë vijon.

Në fushën akademike e mësimore

Neni 1

Palët nënshkruese angazhohen të bashkëpunojnë për rritjen e cilësisë së përgatitjes së studentëve si praktikantë të fushës së psikologjisë dhe punës sociale, si në programe Bachelor dhe Master.

Neni 2

Universiteti "Marin Barleti" do të vërë në dispozicion të këtij qëllimi personelin e tij akademik për çështje të mbështetjes së Qendrës për nevoja të saj, të zhvillimit të mëtejshëm profesional në fushën e psikologjisë dhe punës sociale, por dhe në organizimin të veprimtarive të përbashkëta, shkencore që i shërbejnë zhvillimit sa më cilësor të stafeve respektive

Në fushën e formimit dhe ushtrimit të praktikave profesionale për studentët e fushave të psikologjisë dhe punës sociale, si në programe Bachelor dhe Master

Neni 3

Palët nënshkruese do të punojnë për të zhvilluar formimin praktik të studentëve të psikologjisë dhe punës sociale në Qendër. Studentët e universitetit "Marin Barleti" do të kenë mundësi të njihen me mjediset, me klientët, me personelin, me psikologët, me punonjesit social, si dhe me vizionin dhe perspektivën që synon Qendra.

Neni 4

Studentët do të kenë mundësi të praktikohen në mjediset e qendrës që të kontaktojnë klientë të saj, psikologë, punonjes social dhe drejtues të saj.

Neni 5

Studenti bashkëpunon dhe ka hapësirën e domosdoshme kohore dhe mjedisore për ndërvepruar me psikologët dhe punonjesit social te qendrës, duke iu ofruar mundësi të ndjekjes dhe të të ushtruarit të trajtimeve të shumëllojshme, psikologjike sipas nevojave që të interesuarit ndjekin në Qendër.

Neni 6

Qendra vë në dispozicion të studentit një psikolog/punonjes social me të cilin zhvillohet bashkarisht gjithë procesi i mentorimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale sipas një plani të

miratuar nga psikologu/punonjesi social i Qendrës, nga pedagogu i UMB si udhëheqës i praktikës.

Neni 7

Studenti dhe psikologu/punonjesi social-mentor në përfundim të praktikës plotësojnë dhe Paketën Zyrtare të Praktikës sipas formatit standard të UMB-së, në të cilën nënshkruan psikologu/punonjesi social-mentor, pedagogu udhëheqës, si dhe drejtori i Qendrës. Paketa e praktikës plotësohet nga studenti sipas rubrikave përkatëse dhe dërgohet për nënshkrim të psikologu/punonjesi social-mentor që bën vlerësimin e studentit, te pedagogu udhëheqës dhe më pas te drejtori i Qendrës për nënshkrimet e kërkuara.

Neni 8

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një periudhë 5-vjeçare me ripërtëritje në krye të pesë viteve me dëshirën dhe vullnetin e palëve.

Neni 9

Secila prej palëve mund të tërhiqet nga zbatimi i marrëveshjes, duke lajmëruar palën tjetër të paktën 6 muaj përpara ndërprerjes së bashkëpunimit

Koordinatorë të marrëveshjes janë:

Për Universitetin "Marin Barleti"

Për Qendrën "Jonathan"

Entela Mety
[Signature]

Neni 10

Nënshkruar me vullnetin e plotë të palëve në Tiranë, më 22/01/2018 nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse:

Për SHLUJ Universiteti "Marin Barleti"

Rektori
[Signature]
Prof. Marenglen Spiro



Për Qendrën "Jonathan"

Drejtorë Ekzekutive

